



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 576 Prot
dt 23.04.2018

VENDIM

Nr. 14 _ Data 05.04.2018 _

Për miratim e lejes për shfrytëzim të materialeve inerte, në lumin Shushicë, për ndërtimin e aksit rrugor "By Pass Vlorë - Peshkëpi - Gjorm , Rrethi Vlorë, qarku Vlorë subjektit " Arifaj" sh.p.k. me administratore Znj. Rezarta Bokçiu .

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 44, të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, 416 datë 13.05.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve ë aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit, Nr.1 date 07.07.2011 "Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve "

VENDOSI

Miratimin e lejes për shfrytëzim të materialeve inerte, në lumin Shushicë, në zonën Drashovicë-ura e Peshkëpisë, për ndërtimin e aksit rrugor "By Pass Vlorë - Peshkëpi - Gjorm , Rrethi Vlorë, qarku Vlorë subjektit " Arifaj" sh.p.k. me administrator Znj. Rezarta Bokçiu me këto të dhëna:

SISTEMI KORDINATIV (GAUSS)		
Nr i pikave	X (°, ', ")	Y (°, ', ")
1	4482304.647	4379160.570
2	4482010.550	4379152.126
3	4481645.567	4379348.885
4	4481344.383	4379427.357
5	4481344.383	4379242.988
6	4481697.473	4378994.384

7	4481966.015	4378885.928
8	4482229.243	4378761.063

Sasia e materialit inert 80 000 m3 në vit sipas afatit të ndërtimit prej 2 (dy) vjetësh me sasi të përgjithshme 160 000 m3.

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Leja e subjekteve do të zbardhet deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, dhe kohëzgjatja e lejes deri në përfundimin e kontratës së rrugës.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I K.B.U “VJOSË”

Flamur MAMAJ

PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”

Ilir PROEKA

